



**Prishtinë, 23 dhjetor 2013**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_583\_2013**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 11 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
- Kërkesën e KEDS SH.A të datës 18 dhjetor 2013 për aprovimin e dokumentit “Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes”

**në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2013, nxori këtë:**

**V E N D I M**

**I Aprovohet dokumenti “Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes”**

**Arsyetim**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) me datë 18.12.2013 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit “Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes” të KEDS SH.A., ZRRE ka dhënë komentet e veta të cilat: janë përfshirë në dokument, sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura. Pas përfshirjes së komenteve, ZRrE vlerëson se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara, dhe aprovon “Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Shpërndarjes”.

**II** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

**III** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar